



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË

Nr. 267 Prot

Tiranë, më 12.05./2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit Nr.4, datë 18.08.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 759, datë 30.09.2024" Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Përgjegjës i sektorit të financës dhe administrimit profesional .

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Kritere të posaçme për përgjegjesin e sektorit të financës dhe administrimit :

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “ Master i shkencave”(ose të barasvlefshme) në shkenca ekonomike
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë në profesion sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës ;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës ...28.05.2026
4. Vlerësimi i kandidatëve do bëjë do bëhet referuar përcaktimeve të Udhezimit 759, datë 30.09.2024, “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, perberjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar

